

Balkan Youth Environment Assembly

Ne jemi një ekosistem që mund të lulëzojmë së bashku!

23-25 shkurt - 16:00 - 18:00 CET

Kush jemi ne dhe çfarë përfaqësojmë?

The Balkan Youth Environment Assembly (BYEA) është një nismë e shoqërisë civile e organizuar nga të rinjtë dhe për të rinjtë e Ballkanit, për të mësuar dhe dialoguar rreth çështjeve mjedisore më me shumë rëndësi për ta. Kuvendi rajonal i të rinjve mbështetet nga UNEP Major Group for Children and Youth (UNEP MGCY) dhe u organizua në krye të United Nations Environment Assembly (UNEA 5.2).

Si të rinj në Ballkan, ne shohim diversitetin biologjik të ekosistemeve ekzistuese dhe mënyrën se si ato vazhdojnë të informojnë njohuritë tradicionale ekologjike dhe trashëgiminë kulturore.

Të gjithë ne jemi të veshur me mirëqenien kolektive të jetës njerëzore dhe jonjerëzore në këtë rajon.

Nuk ka kohë për të humbur - veprimet klimatike janë të nevojshme në Ballkan tani për tani.

Duke vënë në dukje vendimin e Këshillit të të Drejtave të Njeriut për të njohur të drejtën e njeriut për një mjedis të sigurt, të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, ne e shohim jetën në harmoni me natyrën, si një përfitim për shëndetin, ekonominë dhe mirëqenien tonë të përgjithshme.

Duke theksuar natyrën e ndërlidhur të ndryshimeve klimatike, humbjen e biodiversitetit, degradimin e tokës dhe ndotjen e ajrit dhe ujit, është thelbësore të bashkëpunojmë brenda rajonit për zbatimin e marrëveshjeve shumëpalëshe mjedisore dhe proceseve mjedisore për përfitimin tonë të përbashkët.

Ne i bëjmë thirrje qeverive, sektorit privat, organizatave joqeveritare të shëndetit publik dhe mjedisit, sindikatave, institucioneve akademike dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile që të vënë shkencën mjedisore sa i përket ushqimit, kafshëve, shëndetit dhe mirëqenies së njerëzve në front të vendimmarrjes.

Duke e ditur se nevojiten burime për të bërë tranzicion në të ardhmen pozitive rurale dhe urbane për natyrën, ne e vërejmë se parandalimi i degradimit të mjedisit, është më i lirë sesa riparimi ose humbja e shërbimeve të ekosistemit, shëndetit dhe turizmit.

Ne konfirmojmë përkushtimin tonë për ekosistemet tona të përbashkëta dhe inkurajojmë krijimin e vendeve të punës me kualifikim të lartë të cilat i shërbejnë mjedisit dhe shoqërisë.

Rekomandimet tona përfshijnë këto tema:

- Kriza klimatike dhe fatkeqësitë natyrore
- Trashëgimia natyrore, biodiversiteti dhe njohuritë tradicionale ekologjike
- Qeverisja e mjedisit dhe menaxhimi i ndotjes
- Energjia e gjelbër dhe teknologjia

Veprimi që Duam

Kriza klimatike dhe fatkeqësitë natyrore

Modelet e projeksionit të klimës parashikojnë se rritja e temperaturave, modelet e çrregullta të reshjeve, ngjarjet e thatësirave të shpeshta dhe përmbytjet, ka të ngjarë të rriten në vitet e ardhshme. Pasojat e përmbytjeve përfshijnë dëmtimin e pronës, shkatërrimin e të korrave dhe humbjen e bagëtive - me ndikime të rënda ekonomike për komunitetet. Rritja e përmbytjeve dhe thatësirave në Ballkanin Perëndimor, do të sjellë rreziqe më të mëdha për ekonominë, florën, faunën dhe shëndetin e njerëzve. Ekziston nevoja që vendet brenda pellgjeve të përbashkëta të lumenjve në Ballkan, të ndërmarrin veprime të përbashkëta në drejtim të gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes, për t'iu përshtatur me sukses ndryshimeve të parashikuara.

Ngjarjet ekstreme gjithnjë e më të shpeshta dhe intensive gjatë dy dekadave të fundit, kanë shkaktuar dëme të mëdha tashmë në Ballkan. Në vitin 2014, përmbytjet historike shkaktuan mbi 2 miliardë euro dëme dhe humbje në Bosnje dhe Hercegovinë dhe mbi 1.5 miliardë euro dëme dhe humbje në Serbi. Verën e kaluar ne ishim dëshmitarë të temperaturave rekorde që mbërthyen shinat e trenave, ndezën dhjetëra zjarre në të gjithë Ballkanin, detyruan Shqipërinë të shpenzonte 200 milionë euro për importet e energjisë dhe shkaktuan një thatësi në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi. Cenueshmëria e rajonit ndaj këtyre goditjeve klimatike, konfirmon raportin e fundit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike, duke parë ndikimin e ndryshimit të klimës në sigurinë tonë ushqimore dhe ujore, produktivitetin bujqësor dhe shëndetin fizik dhe mendor. Këto lloj rreziqesh do të rriten gjatë dy dekadave të ardhshme – por masat e marra tani për tani, mund të na ndihmojnë të përshtatemi me ndikimet. Gjetjet e raportit përforcojnë nevojën për të forcuar zbatimin e Strategjis së Adaptimit në BE, në mënyrë që rajoni i Ballkanit të bëhet më rezistent ndaj klimës dhe të përgatitet për ndikimet e pashmangshme të krizës klimatike.

Zgjidhjet e bazuara në natyrë mund të ofrojnë ekosisteme me kosto efektive dhe rezistencë të komunitetit, ndërkohë që ofrojnë përfitime për mirëqenien njerëzore dhe biodiversitetin. Në Ballkanin Perëndimor, përdorimi i tyre në përgjigje të sfidave shoqërore, mbetet i paeksploruar në krahasim me infrastrukturën konvencionale gri. Për shembull, toka është e gjallë me mikrobe, rrënjë dhe kërpudha mikorizale, të cilat ofrojnë shërbime të ekosistemit të fiksimit natyror të azotit, sekuestrimit të karbonit dhe mbajtjes së ujit.

Termocentralet me qymyr në Ballkanin Perëndimor po çlirojnë dioksid squfuri, okside të azotit dhe pluhur që po kontribuojnë në nivele të konsiderueshme të ndotjes së ajrit dhe po shkaktojnë dhjetëra/mijëra vdekje përveç kostove të kujdesit shëndetësor gjatë një periudhe të shkurtër.

Urgjenca për të zbutur ndikimet katastrofike të ndryshimeve klimatike, kërkon një tranzicion të shpejtë nga sistemet e energjisë të bazuara në lëndë djegëse fosile, në sisteme të energjisë së pastër dhe pa karbon.

Siq modelet e motit bëhen më të pasigurta në rajon, qeveritë brenda Ballkanit do të duhet të marrin qasje gjithnjë e më proaktive, për të garantuar sigurinë dhe prosperitetin e komuniteteve. Nevojiten partneritete të forta ndërkombëtare - dhe investime largpamëse në qëndrueshmëri. Serbia u bë një nga vendet e para në botë, e cila përafroi plotësisht legjislacionin e saj me atë të [Sendai Framework](#) me kuadrin e parë gjithëpërfshirës të menaxhimit të rrezikut të fatkeqësive të rajonit të Ballkanit. Duke punuar jashta kufijve, të gjitha vendet e Ballkanit mund të ofrojnë paralajmërime më të hershme për rreziqet e fatkeqësive dhe klimës për të gjithë qytetarët e tyre.

Rekomandime

- Zhvillimi i planeve të veprimit për klimën, si heqja graduale e qymyrit dhe ridrejtimi i fondeve publike në investime drejt një ekonomie neutrale ndaj karbonit, si: masat e efikasitetit të energjisë, energjia e rinovueshme, zgjidhje të bazuara në natyrë në mbështetje të [EU's 2030 greenhouse gas emission targets](#), [Zero Pollution Action Plan](#) dhe [EU's Renovation Wave Strategy](#).
- Investimi në trashëgiminë kulturore dhe njohuritë tradicionale të popujve indigjenë dhe komuniteteve lokale në Ballkan përmes zgjidhjeve të bazuara në natyrë për ndryshimet klimatike p.sh. infrastrukturën e gjelbër për menaxhimin e përmytjeve.
- Zhvillimi i planeve të përbashkëta të gatishmërisë, përshtatjes dhe zbutjes për komunitetet e margjinalizuara dhe të cenueshme përgjatë pellgut të lumit Drin në rajon duke përafuar politikat legjislative me [Sendai Framework](#).
- Të gjithë aktorët përkatës duhet të udhëheqin, investojnë dhe promovojnë ndërhyrje novatore klimatike në komunitetet lokale, për të ofruar një sërë përfitimesh mjedisore dhe për të krijuar mundësi punësimi gjithëpërfshirëse për komunitetet e margjinalizuara dhe më të cenueshme, duke adresuar pabarazitë ekzistuese në Ballkanin rural.
- Qeveritë e shteteve anëtare në Ballkan duhet të hartojnë një raport vjetor që detajon statusin e të gjitha politikave dhe projekteve të përgjithshme, për të gjurmuar dhe monitoruar progresin e tyre në zbatimin e planeve të tyre të veprimit për klimën. Kjo do të përfshijë gatishmërinë e përbashkët, reagimin dhe koordinimin e rimëkëmbjes ndaj përmytjeve dhe thatësirave.
- Zhvillimi i një strategjie të integruar reagimi ndaj përshtatjes klimatike nën [EU's Adaptation Strategy](#), reduktimin e rrezikut të fatkeqësive dhe përshtatjen e bazuar në ekosistem, duke siguruar gjithashtu që këto politika të jenë jodiskriminuese dhe gjithëpërfshirëse.
- Zbatimi i një Marrëveshjeje të Gjelbër për rajonin e Ballkanit duke promovuar veprime për të dhënë çelësin objektivave të [European Green Deal's](#) sipas [EU Biodiversity Strategy for 2030](#) dhe [EU Circular Economy Action Plan](#).

Trashëgimia natyrore, biodiversiteti dhe njohuritë tradicionale ekologjike

Shëndeti dhe mirëqenia e njeriut varen nga ekosistemet për shërbime dhe përfitime, si ushqimi dhe uji i ëmbël. Biodiversiteti mbështet funksionet dhe proceset ekologjike që sjellin përfitimet e ofruara nga ekosistemet, duke përfshirë pastrimin e ujit dhe ajrit, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, pjalmimin, pjellorinë e tokës dhe qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike. Ndërveprimet mes njerëzve dhe biodiversitetit, mund të ndikojnë fuqishëm në shëndetin e popullatës, mjetet e jetesës dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve në shëndetin publik. Sistemet e të menduarit, duke përfshirë modelet [One Health](#) dhe One Welfare, na ndihmojnë të kuptojmë sesi zhvendosja e kafshëve të egra mund të çojë në sëmundje te njerëzit.

Pasuritë natyrore të rajonit duhet të jenë të qëndrueshme dhe mund të gjenerojnë mundësi të reja biznesi dhe zhvillim rural përmes aksesit në tregje të reja, përpunimit të prodhimeve bujqësore në produkte dytësore dhe turizmit mjedisor. Trafikimi i paligjshëm i bimëve dhe kafshëve të rrezikuara, është një kërcënim për biodiversitetin dhe vjedhje e trashëgimisë natyrore.

Me urbanizimin, njohuritë tradicionale ekologjike dhe kultura rurale po humbasin. Në të njëjtën kohë, të rinjtë në Ballkanin Perëndimor po emigrojnë për shkak të mundësive të pabarabarta për arsimim dhe karrierë. Hendeku rural-urban në të ardhurat, mundësitë e punësimit dhe perspektivat për të rinjtë, duhet të trajtohet me politika dhe masa specifike.

Rekomandime

- Është i nevojshëm monitorimi mjedisor dhe zbatimi i ligjeve mjedisore, veçanërisht në lidhje me zonat e mbrojtura, speciet dhe habitatet.
 - Pranoni dhe zbatoni [CITES - \(the Convention on International Trade in Endangered Species of Wild Fauna and Flora\)](#)
 - Konsideroni zgjerimin e [European Green Belt Initiative](#)
- Investoni në zhvillimin inovativ rural dhe digjitalizimin me teknologjitë e TIK-ut, në një mënyrë e cila përputhet me njohuritë tradicionale ekologjike. Kjo përfshin vende pune në bujqësi precize, teknologji të gjelbra dhe stimul financiar për krijimin e vendeve të gjelbra në Ballkanin rural.
- Njohja e lidhjes mes kulturës dhe mjedisit dhe përfshija në mësimin e njohurive tradicionale ekologjike në shkolla, duke adresuar shkëputjen ekzistuese midis zonave urbane dhe rurale.
- Sigurimi i trajnimeve në praktikën e qëndrueshme për fermerët dhe të angazhuarit në prodhimin e ushqimit në mënyrë që të shmangët degradimi i tokës dhe ujit, për të garantuar sigurinë e ushqimit dhe ujit.
- Sigurimi i mbrojtjes dhe restaurimit të 30% të tokës dhe oqeanit, në përputhje me Axhendën e Konservimit 30x30.
- Njohja e Eco-sensitive zones (ESZ) dhe Ecologically Fragile Areas (EFA) konsiderohen Environmental Protected Areas (EPA) në rajon.
- Identifikimi dhe mbajtja e përgjegjësisë për operacionet e biznesit ekocid që shkatërrojnë, prishin dhe ndotin ekosistemet sistematikisht.

Qeverisja e mjedisit dhe menaxhimi i ndotjes

Ka implementim dhe zbatim joadekuat të ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese të ambientit si dhe angazhim dhe dialog i pamjaftueshëm gjithpërfshirës të komuniteteve lokale për të mbrojtur mjedisin. Të drejtat për të marrë pjesë në vendimmarrjen mjedisore, kufizohen me periudha të shkurtuara të komenteve për propozimet që ndikojnë në mjedis, si dhe me akses dhe shpërndarje të pamjaftueshme të informacionit mjedisor që mbahet nga autoritetet publike.

Projektimi i mbetjeve duhet të jetë një prioritet, pasi sistemet e menaxhimit të mbetjeve mbeten inekzistente. Nuk ka instrumente politike për të inkurajuar përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit për mbetjet plastike. Një traktat i plastikës duhet të përfshijë parime kyçe, duke përfshirë masat paraprake, parandalimin, ndotësit paguan, barazinë mes brezave dhe mosdiskriminimin. Duhet konsideruar për njerëzit që jetojnë në varfëri ekstreme dhe grumbulluesit e mbeturinave, të cilët janë të ndikuar në mënyrë disproporcionale nga ekspozimi ndaj kimikateve në mbetjet plastike.

Rekomandime

- Integrimi i edukimit mjedisor
 - Angazhimi në zgjerimin e kurrikulave arsimore që nga moshën e hershme, në lidhje me shkaqet, efektet dhe zgjidhjet e krizës klimatike, humbjes së biodiversitetit, degradimit mjedisor dhe qeverisjes mjedisore duke siguruar që të bëhen lidhje me ndikimet në mjetet e jetesës, sigurinë ushqimore dhe shëndetin duke përfshirë njohuritë tradicionale ekologjike.
 - Zhvillimi i një fuqie punëtore të gjelbër në zonat urbane dhe rurale përmes programeve të ndërtimit të kapaciteteve për të rinjtë të fokusuar në shkencë dhe teknologji mjedisore.
- Proceset e qeverisjes që kanë në qendër jetën
 - Politikat e mbështetura përmes shkencës më të mirë të disponueshme për cilësinë mjedisore, biodiversitetin dhe gjendjen e një shëndeti përmes ndërlidhjes së fortë shkencë-politikë.
 - Zhvillimi i mekanizmave për lehtësimin e ndarjes së mbetjeve mjekësore dhe mbetjeve të tjera industriale, për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive, veçanërisht për punëtorët në ndarjen e mbetjeve në Ballkan.
- Zbatimi i traktateve mjedisore, ligjeve, rregulloreve
 - Zbatimi i Konventës së Aarhusit dhe mundësimi i së drejtës për të marrë pjesë në vendimmarrje p.sh. komentimi mbi zhvillimet me ndikim mjedisor si dhe të drejtën për të hyrë në drejtësi dhe për të sfiduar vendimet publike që shkelin ligjet mjedisore, me fokus në përfshirjen e të rinjve dhe më të cenuarve në Ballkanin rural.
- Zhvillimi i politikave të menaxhimit të mbetjeve dhe ekonomisë rrethore në përputhje me praktikën më të mirë të BE-së. Fokusimi në parandalimin e ndotjes plastike sipas Waste Framework Directive të Zero Pollution Action Plan. .

- Extended Producer Responsibility (EPR) rrit pjesëmarrjen dhe angazhimin për prodhuesit, industrinë, markat dhe shpërndarësit kryesorë për të zhvilluar dhe miratuar menaxhim të shëndoshë të kimikateve dhe mbetjeve plastike gjatë gjithë ciklit jetësor, dhe për të zhvilluar strategji për kalimin në materiale pakëtimimi të sigurt, p.sh. materiale të certifikuar me bazë bio dhe miqësore detare
- Extended Regulator Responsibility (ERR) lehtëson pajtueshmërinë me menaxhimin e plastikës nëpërmjet mekanizmave monitorues, mund të përfshijë ndalimin e lëndëve jo të biodegradueshme për industrinë e pakëtimimit, si dhe stimuj për zhvillimin e një ekonomie rrethore.
- Extended Consumer Responsibility (ECR) promovon praktikën më të mirë për individët dhe komunitetet për një mënyrë jetese me humbje të ulët deri në zero. Inkurajon shoqëritë që të kujdesen për mbetjet brenda mjedisit të tyre të afërt, përmes aktiviteteve të riciklimit dhe transportimit të mbetjeve në bankat lokale të mbetjeve, si dhe duke përdorur produkte të rinovueshme.
- Qeveritë mund të ofrojnë udhëzime dhe korniza politikash për menaxhim sistematik dhe efektiv të mbetjeve, të ndalojnë deponitë, djegien e paligjshme dhe shkarkimin e mbetjeve të patrajuara.
- Zhvillimin e legjislationit detyruar për industrinë që operojnë në vendin e tyre përkatës në Ballkan, në mënyrë që kompanitë vendase dhe të huaja, të mbeten përgjegjës për ndotjen e ujit dhe tokës.
- Partneritetet në të gjitha nivelet dhe sektorët për të mirën e natyrës dhe ekosistemeve të shëndetshme
 - Zhvillimi i një rrjeti akademik rajonal për të avancuar bashkëpunimin shkencor, teknik dhe teknologjik në monitorimin ekologjik, me qëllim që të forcohet qeverisja e shërbimeve të përbashkëta të ujit, tokës dhe mjedisit.
 - Ministrinë e mjedisit së bashku me partnerët e shoqërisë civile dhe institucionet akademike, duhet të identifikojnë mekanizmat për monitorimin e mbetjeve industriale/të shkallës së madhe midis komuniteteve lokale në Ballkan dhe të testojnë cilësinë e ujit në mënyrë rutinore, për të siguruar që qytetarët të mos ekspozohen ndaj mbetjeve toksike dhe ndotësve të tjerë.
 - Angazhimi në një kornizë EPR-ERR-ECR mbi përgjegjësinë e përbashkët ndaj partneriteteve dhe angazhimeve të qëndrueshme për një ekosistem të shëndetshëm dhe krijimin e vendeve të punës së qëndrueshme që ndërtojnë drejtë SDG-ve.

Energji e gjelbër dhe teknologji

Energjia e gjelbër/e rinovueshme është energjia në të cilën të gjithë duhet të fokusohemi ta zhvillojmë për të ardhmen. Është energjia që dëmton më pak natyrën dhe shëndetin tonë. Rëndësia e energjisë së rinovueshme si era, dielli, biomasa dhe gjeotermale, mbeten të paeksploruara dhe të pazhvilluara në vendet e Ballkanit.

Ngritja e kapaciteteve për organizatat e shoqërisë civile, në zhvillimin dhe zgjerimin e projekteve bazë, mund të arrihet duke lidhur projektet rajonale dhe praktikën e mirë me fokus në edukimin e

publikut mbi dëmet e shkaktuara nga shfrytëzimi i qymyrit, lëndëve djegëse fosile dhe burimeve jo të rinovueshme për energji për mjedisin dhe shëndetin tonë.

Ballkani mund të luajë një rol të rëndësishëm në maksimizimin e ndikimit të Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane. Ky rajon ka një kapacitet të madh, të zhvilluar të energjisë së rinovueshme, me një kapacitet hidroenergjetik dukshëm të zhvilluar. Lënia e Ballkanit Perëndimor jashtë Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane, mund të çojë në pabarazi në çmimin e energjisë elektrike me vendet e BE-së.

Rekomandime

- Zhvillimi i një platforme përmes rrjetit të institucioneve akademike rajonale/ekspertëve për njohuri mbi tranzicionin e gjelbër dhe të drejtë për shoqërinë civile për të edukuar veten, familjet dhe miqtë e tyre.
- Mbështetja e pjesëmarrjes dhe angazhimit të rinjve në avokimin e energjisë së gjelbër.
- Investimi në zgjerimin e potencialit dhe zhvillimin e energjisë së rinovueshme në rajon, si era, gjeotermale, biomat dhe diellore, përveç hidroenergjisë.
- Ne bëjmë thirrje që sistemet e energjisë së gjelbër, të tilla si hidrocentralet, të kenë mjete më të mira monitorimi, transparencë më të madhe financiare, mekanizma të konsultimit publik dhe kërkime mbi ndikimin e tyre mjedisor.